



Dalës-Izazna

Nr. 1117
Br.

Data 23.08.2018
Datum

OBILIQI-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legislatura e VI, mbledhja e 11) me dt.31.08.2018 (e premtë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar i Komisionit vlerësues për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim
4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Babimoc
5. Shqyrtimi i kërkesës së DFEZH-së, për transfer dhe ridestinim të mjeteve, nga vlerat e mbeturat të projekteve për vitin 2018
6. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.07.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Qëndresa Dubova, Agon Mjekiqi, Florije Jashari, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Përparim Klinaku, drejtor i adm. së përgjithshme, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Ferid Hashani, drejtor i bujqësisë, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, përf. e UNMIK-ut

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit veprues 2018-2021 përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të Komunës së Obiliqit
4. Shqyrtimi i raportit gjashtë (6) mujor të punës së Kryetarit të Komunës
5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017 (Zyra Kombëtare e Auditimit)
6. Shqyrtimi i kërkesës së DMM-së, për vënjen në mbrojtje të monumenteve të natyrës
7. Shqyrtimi i Memorandum Mirëkuptimi të Kryetarit të Komunës dhe katër komunave tjera , që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të shpallet zonë me interes të përgjithëshem
8. Shqyrtimi i propozimit të DPUKP për shpallje me intres publik , hapësirat e sheshit dhe përrreth tij në zonën e parë të qytetit
9. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Miratohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

1. Pika e parë e rendit të ditës –

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal.

2.Pika e dytë e rendit të ditës –

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3.Pika e tretë e rendit të ditës -

Burim Gërguri – jep fjalën Ajetit per me sqaru planin per komitetit .

Ajet Berisha-ne baze te vendimit te dates 28/03/2018 qe eshte themelu grupi punus per peripilimin e planit lokal te veprimit per vitin 2018/21 ku grapi ka mbajte 7 takime ku secila drejtori ka bere analizen per gjendjen ose realizimin e planeve te kalume,konstatimin e gjendjes qe o aktuale per keto tri komunitete dhe strategjia ose hartimi i keti plani per keto komunitete. Plani del nga strategjia e qeveris 2017/21dhe jemi perpjek qe te gjitha aktivitetet mi perfshi ne planin lokal, ne kuader ketij plani jane disa aktivitete dhe objektiva qe kane te bejne me arsimin, mirqenien sociale ,shendetsin dhe vendbanimin dhe

ne baze te planit do te shqyrtohen veq e veq si dhe eshte para pa edhe buxheti. Per shkak te disa parregullsive planin perfundimtar do te ju dorzohet per me votim dhe qe obligon ekzekutivin per mi realizu ato aktivitete, ftohen te gjithe te votojn

Sepse qellimi i ksaj pike eshte te ndihen te barabart me komunitetin shumic.

Burim Gerguri – jep fjalen asambleistve

Aziz Bici– per grupe te caktuara eshte diskriminuese me te cilat po perballen komunitetet besoj qe permisimi i gjendjes sociale ekonomike arsimore dhe shendetvore do te arrihet lehte permetes implementimit te ligjit ne fuqi , monitorimit me te fuqishum nga organet kompetente , gjithperfshirja e nxenseve te te ngjitha komunitetve pa dallim etnie, race , gjine dhe statusit social nga mesuesit ,arsimtaret ,profesoret pastaj kujdes shendetor te njejtë per te gjithe qytetaret e komunitetin qe na garanton ligji.Sipas Azizit ne planin lokal te veprimit nuk parashitet qe eshte ndermar diqka per ta dhe se ata po deskriminohen.

Ajeti Berisha- ku thote qe gjendja e ketyre tri komuniteteve eshte e rende por qe ligji vlen per te gjith njejt dhe qe qellimi i planit nuk eshte per me favorizu vetem njerin prej tyre por qe do te zbatohet per te gjithe per keto komunitete ne planin e tyre duhet masa shtese sepse nuk shkojne ne shkolle.

Shaip Paloja- sipas tij te gjitha komunitetet duhet te integrohen sepse edhe ligji kete i'a mundson per qe integrimi svaret vetem prej organeve te komunes tone por edhe nga ata persona qe dojne mu intergru ne mjedsin qe jetojne . Tri komunitet thuhet qe kane problem me ligjin sepse sipas tij nga fshati qe vjen ka rome qe kan kry edhe krime kane djeg shtepi,kane marre pjes edhe ne vrasje poashtu sipas Palojes problemet rreth ujit, energjis elektrike , punsimit nuk jan problem vetem per komunitetet por i perfshin edhe serbet dhe shqiptaret.

Nazmi Gashi-sipas tij grupi punues e ka bo ma tmiren per planin per komunitete poashtu ata kan biseduar me komunitetin qe ti formojne komisione per me dal ne teren dhe me verifiku gjendjen ose ndryshimet dhe kryesuesi i komunitetit me dhene raportin rreth asaj gjendje .

Hysni-sipas tij komuna jone e avancon me shume se te gjitha komunat e tjera planin per komunitete dhe se jan shtru rruge jane ndertu pallate dhe asnjehere nuk jane anashkaluar nga ana etyre .Dihet qe komuniteti kane nevoje te madhe por qe komuna jone vazhdimesht eshte mer me problem te tyre dhe qe asnjehere nuk ka pasur ndonje problem ndermjet vete ose qe ata e ndjen qe jan te rrezikum dhe qe do ta zbatojn ligjin per te gjith njesoj .

Azizi-thekson se gjendja e tyre osht ka ju konvenon dhe sipas tij ajo qe foli Jakupi dhe Hysnia nuk osht e perputhshme me realitetin e tyre dhe qe sipas ksaj situate po pengohet integrimi i tyre.

Hysi-thekson se eshte keqkuptuar nga ana e Azizit sepse ajo qe tha ai ishte se te gjithe e dine qe komuniteti ka problem te medha per qe komuna jone eshte mer me problemet e tyre dhe asnjehere skan qene te diskriminuar .

Ajeti-thekson se per komunitetin shkojne plane shtese tu u nis per ndonje semundje siq ishte fruthi ose kur ata lene shkollen ne duhet mar plane shtes qe mu angazhu qe ata me marr pjes ne shkolle kan obligim ligjor mu kujdes per te gjithe qytetaret.

Azizi-gjendja per komunitete eshte e rende , eshte e dyshimt qe ka korruption hajni dhe dojne mos mu integruje keto komunitete keshtu qe ai bene thirrje te hartohen programe per integrimin e tyre. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota “Për” 1 votë “Abstenim” dhe 1 votë “Kundër morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Obiliqit 2018-2021.

4.Pika e katërt e rendit të dites –

Burim Gerguri-tregon qe komuna jone renditet e pesta qe kryetari raporton para kuvendit qdo tre muaj qe te jete ma transparent per shpenzimet dhe obligimet financiare jo vetem sipas ligjit qe duhet qdo 6 muaj.

Kry.Xhafer Gashi-thekson se plani eshte vuliminoz sepse perfshire aktivitete te shumta si dhe do cilsohet si qeverisjet ma te mdhaja se o ka punohet shume duke fillu me ligjin per Obiliqin , ndertimi i kosoves se re ,minierave ,plani zhvillimore, sheshi ,lagjia e re e Hades etj poashtu jan nenshkruar disa memorandume ku ni pjes e projektve vetem ka filluar ni pjesa eshte vetem ne trajtim si dhe sheshi ka kalu ne fazen e dyte edhe pse ka disa probleme komuna o tu punu per me arrit mi realizu te gjitha qa ka ne planin e tyre .

Shaip Paloja –thekson se ne baze te raportit kryetari ka pas disa takime mr qeverin ,ministrat dhe disa parlamentar mirpo ligji per obiliqin njhere per njhere nuk do te funksionalizohet si arsy e miratimit te ligjt tjeter te minierave dhe mineralave edhe pse buxheti ne rapport eshte rrjedhoje e ligjt te obiliqt mirpo nuk do te realizohe.Ai propozon qe me nxjerr ni vendim qe te behet nje aneks kontrat te kontrates se meparshme dhe te definohen te gjitha interesat e qytetarve tone dhe te perpilohet nga njerez profesionist. Sa i perkete suvencionve qe o ne te mire te bujqeve dhe blegtoreve eshte nje vrejtje qe po shkojne per militantet partiak ose tek ata qe kan dike te punsuar ne komune, thote qe komuna duhet te kujdeset me shume per ndotjen ,ujrat e zeza ndersa sa i perket drejtoris se financave thote qe po behen shpenzime te panevojshe dhe si per fund per drejtorin e shendetis thote qe shuma e madhe e parave qe po shpenzohet at here po keqperdoret ose nuk po kursetet.

Kry.Xhafer Gashi – thekson se ligji per miniera dhe minerale dhe ligjet e tjera e plotesojne ligjin per Obiliqin per me qene i implimintushem. Kryetari thekson se implemetinimi i ligjit per Obiliqin do te filloj prej 1 Janarit ndersa sa i perket ndertimit te kosoves se re ne trjanimi 3 ditor qe eshte mbajtur ne kemi dhene disa rekomandime qe jan ne te miren e vendit tone per ndertimin e saj nder to punsimi dhe pergaditja prefesionale ,reduktimi i ndotjes ,rritje dhe mbirbatje te infrastrukturet etj.sa i perket shpenzime te rrymes eshte se me pare ngrohja eshte bere me nafte tash behet me rryme.

Jakup-thote qe telash t'vetum e ka me drejtorat kerkon nga ta te jene menaxhera me ta mire ashtu qe te jene edhe drejtoria te mir dhe ta mbrojme ate qe kane ndertu .

Fatosi-kerkon sqarimi per raportin e kontratave te nenshkrimit publik prej Janar-Qeshor, per furnizimin me gjera ushqimore dhe senitari dhe per blerjen e garderoberes per inspektor komunal.

Aziz-sa i perket ndertimit te Kosoves se re thote qe marrveshja eshte vetem ne gjuhen Angleze nese eshte e vertet at here si mune te filloj implementimi i saj perderisa nuk eshte ne gjuhen shqipe kerkon nga kryetari te sqarohet me shume rreth kesaj marrveshje pershkak qe nuk ka mundesi te merret informacione ne gjuhen shqipe , si pytje e dyte eshte per Administraten e pergjithshme per faqen 6 tabela ku thote qe jan zero te pranuara temiratuar te refuzuara ..pytje tjeter per drejtorin se bujqesisi dhe zhvillimit rural se ne baze te cilave kritere jane zgjedhur bujxit per te marre suvencione , per drejtorin e arsimit mungesa e nxenseve pytje tjeter per drejtorin e financave thote se eshte shperndarje e pabarabarte mes meditjeve dhe pagave qe ndikojne ne mirqeninen e qytetarve ku sipas tij rreth 70% buxhetit shkon ne pagat ne meditje ndersa pjesa tjeter ne projekte dhe pytja per fund eshte cilat jan ata mallra per zyren e krytarit qe prekin shumen prej 700 euro .

Burim Gerguri-thote qe inkasimi i te hyrave ne kete 6 mujor perfshire shumen prej 5006000 euro per drejtoreshen sa ka planifiku nga t'hyrat dhe sa ke mbledh.

Zara Behluli – sipas pytjes per shpenzimet e udhetimeve jasht vendit atehere niveli komunal kur ka udhetime zyrtare jashte vendit llogariten si shpenzime e udhetimit jasht e vendit , meditjet jashte vendit ku i lejon ligji , akomodimi i udhetimit zyrtar jashte vendit , sherbimet e perfaqesimit per avokatur , agjensioni zhvillimor rajonal dhe asosacioni i komunave qe jane te lidhura me marrveshje qysh prej viteve te me hershme dhe vazhdon ende .Furnizimi me ushqim dhe piye dhe dreka jozyrtare jane ushqim per femij ne qerdhe , shpenzimet e informimit publik, informim publik me tender , pagat buxheti eshte

miratuar 2017/18 ku perqindja me e madhe shkon ne mallra, sa i perket shpenzimeve te kryetarit eshte njeri prej tyre qe ka creditcart dhe nuk e shfrytezon mirpo i bene vetem disa urime dhe nuk mer meditje . **Sherifi**-kemi ble inspepcionit garderoben , deri me tash kontratat jan nenshkru dhe kan raportin dhe deri me tani jane nenshkru 38 kontrata .

Perparim Klinaku –sa i perket tables qe eshte bere pytja ajo paraqet totalin e lendeve te cilat jane pranu nga qendra per sherbimet me qytetare dhe ne kete forme eshte i ndertuara programi qe eshte i parapame per komunat , sqaron tabelen qe nuk eshte kuptuar nga te tjeret .

Ferit Hashani –perzgjedhja per buqit qe te marin suvencione e bene komisioni dhe pavaresisht qendrimeve politike te gjithe perfitojne .

Ibush Mjekiqi-me karburant ngrohet vetem qendra per pune sociale ndersa pagesa per rrym eshte per QKMF per qendrat e mjeksis familjare ne Millosheve,ne Babimoc,ne Plementin,ne Brezhnice dhe shtepine e pleqve d.m.th. kjo eshte shuma qe paguhet per kto objekte jo per qendren per pune sociale.

Xhafer Gashi-kemi kerku mu bo ni aneks shtese i kontrate dhe kontrata u nenshkru mes qeverise dhe kontraktusit .

Aziz- kerkon sqarim shtese per suvencionet

Burim Gerguri – thote qe qeshtja per Kosoven e re eshte duke u marur shume serjozisht nga ana e Kryetarit dhe vete komunes.

5. Pika e pestë e rendit të dites –

6.Pika e gjashte e rendit te dites –

Shaip Paloja –vlerat natyrore a do te jen prone private apo a do te kete nevoje te shpallen per interes publik sipas tij uji mineral ne Grabovc eshte prone private.

Burim Gerguri-nuk behet shpallje por eshte instituti per mbrojtjene natyres e tyre dhe ka kerksa per futjen ne trashegemini dhe eshte prone private dhe publike .

Arben- nuk do te behet tjetresim i prones por do te vuhen ne mbrojtje te ministris perkatese keshtu qe edhe mirbajtjen edhe kujdesin e mer vet ministria .

Shaipi-pyetja nese eshte prone private dhe vendos me ndertu diqka a munet me ndalu ose qfar masa meren per ndalim te ndertimit .

Arbeni –nuk behet fjale per parcela por per at monumentin qe eshte ne mbrotje dhe nese e prish drunin ose e pren ai nuk ka te drejte .

Xhafer Gashi –te drunjet qe jane ne Sibofc perderisa ata jane nen mbrotje nuk guxohet te prehen soe te shendrrohen ne diqka tjeter dhe keshtu ato kalojn nen perkudjesen shtetore kommunale ku mund te behen si pika turistke ne te ardhmen por qe eshte e ndalushme ndertimi nese eshte ne mbrojtje p.sh ne oborrin e Xhamis jane tre ose kater drunjje qe jane ne mbrotje dhe slejohet mi pre .

Luli- desha ta di a hyjne si monumente edhe qeshmet e vjetra siq jane qeshmja e Sibofcit eshte tjetra te Nicat ku quhet si qeshmja e Hasan Nicit kisha desht mu mbrojt si monumente dhe kontribu ne to .

Arbeni-duhet te behen perpjekje qe mi fut nen mbrojte .

Pas diskutimeve antaret e kuvendit Komunal me 19 vota ‘Per’’ asnje ‘Abstenim’’ dhe asnje ‘Kunder’’ moren ket vendim:

V E N D I M

Aprovohet shqyrtimi i kërkesës së DMM-së, për vënjen në mbrojtje të monumenteve të natyrës

7. Pika e shtatë e rendit te dites

Kry.Xhafer Gashi-eshte një memorandum mirekuptimi qe komuna jone ka marr pjes me tvetmin qellim qe te shkembejm pervoja pastaj takim tjeter ka qene ne Drenas dhe eshte mar si ide per shkak te Bjeshkeve te Qyqavices qe llogartitet si zone e vegant per turizem dhe per zhvillim , pastaj ne Skenderaj ka qene takimi i radhes ku eshte pergadit memorandumi dhe eshte nenshkru nga 5 komuna qe i prek kjo zone , qellimi eshte te ndertohet nje rruge e cila do t'i perfshije kete bjeshke dhe secili komun planifikon me zhvillu zonen turistike dhe me fute nen mbrotje ndersa pjesa malore i takon agjensionit te pylltarise .

Luli-njofton kryetarin qe eshte nje rruge qe lidh 4 komunat pjeserisht lidhet me komunen tone (rrg.Nazmi Bequku).

Kryetari- sqaron rreth rrugve ..

Hysni-thuhet te shpallet zon me interes e per gjithshum por komuna jone ka shum pake siperfaqe ne kete drejtim sepse Qyqavica rrjedh nga lapidarit e deri ne Kole keshtu qe kerkon me dite a pronat private a duhet mu mbrojt me te njeten menyr si pronat shoqerore.

Kry.Xhafer Gashi – qellimi eshte me kriju nje infrastruktur rrugore ku secili komun me kan participuese per pjesen e vete mirpo per kete rrjet barra kryesore ju shkon qeverise pra ministries se infrastructures dhe punimet eshte dashte me fillu vitin e ardheshum poashtu komunat duhet pjesen e vete me bashkefinancu mirepo krejt qa duhet te behet eshte ti ruajm pyjet mos ti demtojm ato .

Azizi- a do te ndertohet rruga kurrizit te Qyqavices dhe a ka ndonje investor qe eshte lajmru sepse ketu nuk flitet vetem per mbrojtjen e pyjeve por edhe per zhvillimin e turizimit , propozon me analizu mire qe mos te behen shpenzime te kota pasi qe nuk ka ndonje investor serioz per kete pune .

Kryetari – nuk kemi arritur qe ta bejem prone tone qe ta menaxhojme mirepo qe ka te interesuar qe me zhvillu hoteleri dhe turizem ne ate zone mirepo momentin qe prona esht e jona athere kem te drejt te merim me qeshtjen e investitoreve dhe me bo ni plan sbashku me komunat qe mos me bo tnejte investim te gjith njejt.

Xhezide- pytje si mundem ne ta shfrytzojme ate kur e dime qe eshte larg prej neve dhe jemi te izolun nga deponime te mirashit , Kosoven B etj cilat jan perfitimet e qytetarve te obiliqt.

Kryetari –nuk eshte larg per ata qe e dojne ajrin e paster vetum ku eshte qe ne te arrijem ta bejme nje zone atraktive .

Burime Gerguri –Falenderon kryetarin per kete iniciativ sepse eshte ne te miren e secilit prej neve per nje ambient me te paster dhe lexon tri nene per reth ketij memorandum ..

Pas diskutimeve antaret e kuvendit Komunal me 18 vota ‘Per’’ asnje ‘Abstenim’’ dhe asnje “Kunder” moren ket vendim:

V E N D I M

Aprovohet Shqyrtimi i Memorandum Mirëkuptimi të Kryetarit të Komunës dhe katër komunave tjera , që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të shpallet zonë me interes të përgjithëshem

8. Pika e tete e rendit te dites -

Arbeni-propozimi eshte pergaditur per sheshin dhe per qdo pyetje mund te japim per gjigje edhe pse sheshi i prek disa prona dhe kerkohet shpronsimi i tyre .

Luli- pyet se a jane bere paralogari te tersishme per kosoton per me realizu kete project.

Arbeni-kemi prona te perziera njera eshte e Kek-ut ku kryetari ka be perpjekje qe sbashku Me kek-un te hyjne ne bashkfinancimin qe mos me mar na shpronsimin e tyre pastaj kemi prona te Akp-se qe duhet edhe me ta te negociohen per me marr mundsin e pronesis se prones qe ne te jemi pronar te tyre tjetera eshte qe ne fletat poseduese kem banesa qe pronaret e tyre nuk i kan tye regjistruar ne kadaster ku ne do ti regjistrojme dhe sipas te gjitha ketyre del edhe kostoja ne fund.

Labi-a do te shpronsohet qebabtroja Meti apo vetem banesat qe jane perpara kolektive

Arbeni-do te jete komplet kjo pjes qe do te pronsohet por do te behet me faza faza e 1 do te jete komuna e vjeter te pjesa e shtepise se kultures pastaj pjesa tjeter ku do te shpallet zone me interes nacional do te pamundesohen ndertimet .

Jakupi-a do te heket hapsira e kuksit a po punohet ne ate drejtim sipas rregullave eshte zone e pare zone e qytetit

Kry.Xhafer Gashi-si ide fillestare ka qene ndertimi i sheshit mirpo kem shume paqartesi me prona ku kem prona te kek-ut , prona shoqerore, komunale dhe problemi me i madh eshte me akp-ne per shkak te procedurave dhe jane dy objekte te Akp-se, ndersa sa i perket kostos me e mira eshte me bo nje memorandum me kek-un qe pertshkak demve mos me bo kompensim ne po me qene pjes e sheshit.

Mirepo per fillim jemi ne fazen qe duhet ti shpallim zone me interes perndryshe nuk mundemi me vazhdu me tutje .

Hysnia- ketu po diskutohet per tri prona : prone publike ,private dhe shetrore dhe eshte e parapame qe do te kemi problem por qe duhet te ballafaqohemi me to keshtu kekoj nga drejtoria perkatese qe ne seancen tjeter te kuvendit te na sjellin ni raport p.sh sa familjar banojne aty , prona kujt i takone, koston etj. Eshte projekt qe i'a vlen te perkrahet dhe te punohet shume ne te .

Kry.Xhafer Gashi-na presin pune te medha port e gjithe bashkarisht do te mundohemi qe sa ma shpejt te fillojme me punime . Problemi me i madh qendron me Akp-ne kete shqetesim e kemi ngrite edhe ne neveri dhe shume shpejt do te zgjidhet por ato objekte qe jane nen pronsi te kek-ut jane duke u shqyrtu dhe do te zgjidhet edhe problem me banesat e hades1,2 dhe barakat .

Shaip Paloja-cili eshte plani qe ka kalu

Kryetari- projekti 1 nuk ka pase qarkullim , projekti 2 eshte ne debate eshte mare si ma i arsyeshem i cili ka edhe rrugen mirepo ka mjaft telashe te pronsimet por edhe si pike e dobet e kemi edhe posten per arsyte te buxhetit te tyre

Burim Gerguri- pom vjen mire qe bashkarisht po arrijme mu pajtu per zhvillimin e qytetit dhe uroj qe ky shesh te jete veper madhore per Obiliqin.

Pas diskutimeve antaret e kuvendit Komunal me 18 vota ‘Per’’ asnje ‘Abstenim’’ dhe asnje “Kunder” moren ket vendim:

V E N D I M

Aprovohet Shqyrtimi i propozimit të DPUPKP për shpallje me intres publik , hapësirat e sheshit dhe për rreth tij në zonën e parë të qytetit

Burim Gerguri-kerkesa nr.7 e Zejnullah Bajramit eshte lene te trajtohet nga DSHPI-ja , kerkesa e DKRS-se per ndryshim plotesimi te rregullores 157 eshte vendim formal qe na duhet marr vendim keshtu votohet per te. Aprovohet qe rregullorja te dale ne diskutim .

Nje kerkes shkone per mbledhjen e ardhshme si dhe behet shfuqizimi i nje vendimi ...

Votohet per alokimin i mjeteve per paga dhe meditje ..

9.Pika e nentë e rendit të dites

Hysnia-kerkes nga shumica e pensionisteve ku dihet qe ka qene nje puntor qe ka kry sherbime e lajmrimive dhe q’lajmrimive te pensionisteve dhe tanj ajo zyre ka kalu ne prishtine dhe ka ankesa te shumta qe zyrja te sillet edhe sherbimet e pensionistve te kryhen ne vendin tone e jo te maltretohen nga Obiliqi ne Prishtine .

Kryetari-kemi biseduar rreth kesaj situate dhe do vazhdojme perseri...

Mbledhja përfundoi në ora 14:20'

Procesmbajtesja

Suzana Hashani

Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri

